

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dita e 113 e protestës - VIDEO/ Thirrja e qytetarit: Ta shërojmë Shqipërinë nga korrupsioni. Fatin tonë e vendosim ne
ADRESA	https://www.syri.net/politike/918044/video-thirrja-e-qytetarit-ta-sherojme-shqiperine-ng-a-korrupsioni-fatin-tone-e-vendosim-ne/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 18:44:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 18:32:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2aa9d03c8d8189014e1acca4ea4c3394fbe0b209dceec2ad794b24df5841098f
TEKSTI	59858b749eb5e7a12596a5ecc21a4a26fcaa7dd8f96a1671ac121da04144bdcd
PAMJA	d282e5cec40e40f35ad7316de570d858412b4dc0651d44bb530d4028c942e050

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	710311256fb371abee1fc6fb475805851a3393a6aba166240a78bc49c26a3701
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e177be5550b4bd5f7d602f1900530a2156b51a950cd15b25e46c1bef83200b8c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.


Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/710311256fb371abee1fc6fb475805851a3393a6aba166240a78bc49c26a3701>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshija e Tiranës**LAJMI I FUNDIT****Protesta e 113 kundër Edi Ramës/ Mbyllen fjalimet para Kryeministrit, qytetarët nisin marshimin në Tiranë****më të lexuarat****'Akuza të stisura politikisht', Saiti:**
Dënimi i krerëve të UÇK, jo në emër të
Kosovës**Takimi sekret i DEA-s me vendet e**
Amerikës Latine/ Si po i damkos
shqiptarët narko-shteti i Edi Ramës**Ura shembet 1 javë pas inaugurimit/**
Vata: 40 mln lekë nga paratë e qytetarëve
të hedhura në lumë**By Pass i Elbasanit/ 'Karakaci në rrugën**
e Ballukut', Himci: S'dihet kur do
përfundojë, tenderat po vidhen**Ligji për statusin e magistratëve të hiqet**
nga rendi i ditës, Bardhi denoncon
skandalin: Në Kuvend versioni i ri i
pakonsultuar me asnjë...**VIDEO/ Thirrja e qytetarit: Ta shërojmë
Shqipërinë nga korrupsioni. Fatin tonë e
vendosim ne**

20:32, 20/09/2026

ZMADHO TEKSTINProtesta e pandërprerë para Kryeministrit, ku kërkohet dorëheqja e kryeministrit
Edi Rama, ka hyrë në ditën e 113-të.Gjatë protestës, një prej qytetarëve mbajti një fjalim, duke e cilësuar qëndresën si
një përballje të shoqërisë shqiptare me atë që ai e përshkroi si 'një sistem mbytës
dhe korruptiv'.Sipas tij, sistemi politik ka ndikuar në largimin e shqiptarëve nga vendi dhe ka
krijuar përçarje mes atyre që kanë mbetur.

'Vëllezër dhe motra, bashkëluftëtarë të këtij udhëtimi prej 113 ditësh.

Kjo protestë është një nga ngjarjet më të rëndësishme të shoqërisë shqiptare.
Sepse ka në thelb luftën e kësaj shoqërie kundër një sistemi mbytës.Një sistem që ka 36 vite që vetëm forcohet dhe vetëm hyn thellë e më thellë në
venat e kësaj shoqërie.Një sistem korruptiv që po mban peng çdo dëshirë tonën për të jetuar në një
Shqipëri të denjë.

Një sistem korruptiv që rrënjët i ka në parlament.

Ne në gjithë këto vite jemi munduar të bëjmë më të mirën për këtë vend, por ky
sistem ka ndryshuar rrënjësisht vullnetin tonë, duke na marrë përmes pushtetit të
dëgjohemi dhe aftësinë për të bërë bashkë si shoqëri.

Përmes pushtetit, ata i kanë detyruar shqiptarët të largohen nga vendi i tyre.

Kanë përçarë ata që kanë ngelur këtu duke i përndarë përmes bindjeve, duke u
ndërtuar një jetë shumë e vështirë dhe duke i bërë të vrapojnë pas nevojave.

I kanë bërë shqiptarët të harrojnë shpresën dhe e kanë kthyer heshtjen tonë në armën e tyre më të fortë.

Ja ku jemi sot.

Në gjithë këto vite, ata që kanë vendosur për fatin e Shqipërisë janë vetëm politikanët e kriminelët.

Vendi nuk është zhvilluar drejt mirëqenies, por drejt interesave të këtyre klikave mafioze.

Shqiptarët nuk janë trajtuar si zot të këtij vendi, por sikur fati i keq i solli të jetojnë këtu.

Këto 30 e ca vite kanë qenë grada më e lartë e këtij sistemi korruptiv.

Më mirë se kaq ky sistem korruptiv nuk ka ku të shkojë më.

Ndërsa për shqiptarët, më keq nuk ka.

Jemi përballë faktit që nëse ky sistem vazhdon, ne do të paguajmë me breza të tëra çdo skandal që këta prodhojnë.

Do të jetojmë sipas mënyrës që këta përcaktojnë dhe nuk do të kemi mundësinë kurrë ta ndryshojmë këtë realitet, sepse ky sistem na ka vrarë besimin mes nesh dhe na ka vënë në radhë si pengje për karriget e atyre që kanë ndërtuar këtë sistem.

Ky sistem është një gangrenë që ka hyrë thellë në mendjen e Shqipërisë.

Dhe kjo gangrenë kërkon ndërhyrje.

Por ndërhyrja nuk duhet të jetë vdekjeprurëse.

Ndërhyrja duhet të jetë shëruuese.

Gangrena do të hiqet me çdo kusht.

Por më e rëndësishmja, mendja e kësaj shoqërie duhet të jetë e pastër, të kurrë të mos harrojmë rrezikun që kjo gangrenë po i shkakton.

Në gjithë këto vite, ne jemi bërë mish për top për rotacione politike.

Dhuna e instrumentuar ka qenë gjithmonë mjet për marrjen e pushtetit, për zbatimin e pushtetit dhe për interesin e politikanëve.

Por në çdo rast, dëmin e kanë paguar vetëm shqiptarët.

Dhe në gjithë këto vite, çdokush ka të drejtën e Zotit të ndihet i revoltuar dhe t'i bëjë shkumb e hi këtij sistemi, jo të presë që t'i japë mandatin e radhës.

Por nuk do të harrojmë kurrësi që kjo luftë nuk është vetëm kundër një personi, por është kundër një mendësie që rrënjët i ka shumë më thellë se te një individ.

Dhe kjo mendësi luftohet çdo ditë me çdo lloj mënyre.

Dhe pikërisht kjo mendësi mund të sjellë që përmes dhunës të bëhemi përsëri pre e interesave të tyre.

Ne duhet ta luftojmë me çdo kusht këtë sistem korruptiv.

Por fillimisht duhet të shohim qartë se kush janë ata që e kanë krijuar, kush po e mban gjallë dhe çfarë e ka ndaluar rrugën drejt evolucionit.

Kjo protestë ka sjellë fitore të mëdha në këto 113 ditë.

Jemi sot të aftë të vijmë në shesh për veten tonë dhe jo për fytyrën e dikujt tjetër.

Jemi sot të aftë të bëhemi bashkë përtej bindjeve që na bëjnë ndryshe.

Jemi sot të aftë të kthejmë në jetë Shqipërinë që ëndërrojmë.

Jemi sot të aftë të luftojmë për Shqipërinë dhe jo për politikanët.

Kjo protestë i ka lejuar qytetarëve të jenë sovranë i vendit.

Të dalin dhe të vendosin vetë për fatin e tyre.

Me të vërtetë, vendi ynë është në një depresion social, si pasojë e një sistemi që ka marrë peng vullnetin e shqiptarëve.

Por në këtë problem, ne do ta luftojmë duke u bërë të gjithë bashkë si qytetarë të lirë.

Prandaj ta vazhdojmë këtë protestë me çdo kusht, ta rrëzojmë këtë sistem që na ka marrë nga ta shënimë Shqipërinë nga samsundia e korrupsionit dhe të

'Rusia synon përçarjen'/ Burimi: Sulmet hibride për të sjellë në pushtet forcat që nuk ndihmojnë Ukrainën

'Vendimi i Hagës, i pabazuar dhe pa fakte', Veseli: Akuzat, të stisura e fabrikua në Serbi

Bardhi - Ramës: Po hakmerresh ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve se të trokitën në derë për aferat ku je zhytur

Begaj dekreton rrokadën në qeveri/ Firmos shkarkimin e Lamallarit, emërimin e Ervin Demos, 'shkrijen e 2 ministrive në 1'

shkojmë drejt asaj Shqipërie të lirë dhe të zhvilluar, ku fatin tonë e vendosim ne dhe jo interesat e politikanëve.

Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe shqiptarët!', tha protestuesi gjatë fjalës së tij.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Protesta e 113 kundër Edi Ramës/ Mbyllen fjalimet para Kryeministrit, qytetarët nisin marshimin në Tiranë



Donika Gërvalla është simbol i drejtësisë dhe të së vërtetës!



113 ditë protestë/ Qytetarët mbërrijnë para Kryeministrit, kërkojnë dorëheqjen e Ramës

TË NGJASHME



113 ditë rezistencë/ Qytetarët sërish në protestë para Kryeministrit: Rama jepe dorëheqjen



'Rusia synon përcarjen'/ Burimi: Sulmet hibride për të sjellë në pushtet forcat që nuk ndihmojnë Ukrainën



Ura shembet 1 javë pas inaugurimit/ Vata: 40 mln lekë nga paratë e qytetarëve të hedhura në lumë



Miliona euro janë marrë, ndërsa Rama thotë se Becchetti do të marrë zero lekë!



VIDEO/ Dasho: Ministria nuk duhet të bëjë premtime pajisjesh, detyra e saj të menaxhojë sistemin shëndetësor



Blushi thërret në interpelancë Ramën: Çfarë masash do marrë Qeveria për të rrëzuar aktgjykimin ndaj ish krerëve të UÇK?



Vrasja në Sarandë/ Balliu: Krimi ka dalë jashtë kontrollit, problemi është Edi Rama

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net